



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 14/08/2019

Ref.: 1446/15D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 76-të të mbajtur më 25.07.2019 mori këtë:

#### V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e BPrAL Kolegji Universum nr. 1010/19H, datë 24.06.19 për plotësim të stafit akademik për programin Gjuhë Angleze BA
- II. Rikthehet akreditimi për programin
  - Gjuhë Angleze, BA 180 ECTS (me specializim: 1. Anglishte për Biznes dhe Media, 2. Përkthim, 3. Anglisht me Gjuhë Gjermane)
- III. Akreditimi i këtij programi studimor është i vlefshëm për periudhën e njëjtë me vendimin për zgjatje të akreditimit: 30 Shtator 2020
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

#### Arsyetimi


I. Në mbledhjen nr. 61, të mbajtur më 15.01.2019, Këshilli Shtetëror i Cilësisë i AKA-së ka analizuar gjendjen e mbulueshmërisë me staf akademik të programeve studimore, në përputhje me Udhëzimin Administrativ

15/2018. Për shkak se Kolegji Universum ka mbetur pa bartësin e programit në programin Gjuhë Angleze BA 180 ECTS, KShC ka vendosur të tërheq akreditimin e këtij programi studimi deri në plotësimin e tij me staf akademik relevant. Si rezultat, BPrAL Kolegji Universum ka dorëzuar dosjen e znj. Feride Lohaj, e cila pas verifikimit nga AKA dhe KShC, rezulton të plotësoj kriteret e parapara me UA 15/2018, ndërsa që edhe fusha e saj e specializimit në nivelin PhD është në Gjuhë dhe Letërsi Angleze.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Universum
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

